



**Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri**

**RAPORT NGA KRYETARI I PREZENCËS SË OSBE-SË NË SHQIPËRI
PËRPARA KËSHILLIT TË PËRHERSHËM TË OSBE-SË, 16 TETOR 2008**

1. HYRJE

Që nga Raporti Vjetor nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri (Prezenca) përpara Këshillit të Përhershëm në shtator 2007, Prezenca ka marrë masa që puna e saj të ndjekë udhëzimet e dhëna nga Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së dhe Sekretariati dhe që kjo punë të pasqyrojë përparësitë e vendit pritës. Prezenca është kujdesur që të sigurojë që programet e saj të ishin plotësisht të bashkërenduara brenda Prezencës, me Misione të tjera në Terren të OSBE-së në rajon dhe me donatorët me qëllim shmangien e dublimit. Përqendrim më i madh u është kushtuar projekteve më të mëdha strategjike dhe numri i projekteve më të vogla ka ardhur duke u zvogëluar në përputhje me reagimin e marrë si nga vendi pritës ashtu edhe nga Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së. Vizita e zhvilluar në maj 2008 nga një delegacion i Komitetit Këshillimor për Menaxhimin dhe Financat i dha një shtysë të mëtejshme punës së Prezencës për projektet kyçe dhe kontribuoi në forcimin e marrëdhënieve me vendin pritës.

Duke qenë se ky raport vjetor qëllimisht synon të përqendrohet në veprimtaritë e projekteve të Prezencës të ndërmarrë që nga raporti i kaluar për Këshillin e Përhershëm, pjesa e parë do të ndalet vetëm në disa prej ngjarjeve kryesore politike në Shqipëri, duke prekur ato çështje që lidhen më ngushtë me punën e Prezencës. Në dallim nga vitet e mëparshme, viti i fundit u karakterizua kryesisht nga një periudhë gjatë së cilës dy partitë më të mëdha politike arritën të gjenin një mirëkuptim të gjerë politik për programin e reformave.

2. NGJARJET KRYESORE POLITIKE

Për Shqipërinë, ftesa për t'u anëtarësuar në NATO gjatë samitit të Bukureshtit shënon ngjarjen më madhore politike. Kjo ngjarje ishte gjithashtu faktori parësor për të shpjeguar përse partitë kryesore politike filluan të zhvillonin një konsensus ndërpartiak për çështjet kryesore strategjike, gjë që nga ana tjetër pati një ndikim pozitiv në procesin e reformave – siç do të vërehet dhe më poshtë. Ekonomia ka vazhduar rritjen me një përqindje të shëndetshme prej 5.0% të Prodhimit të Brendshëm Bruto, megjithëse rritja e çmimeve të karburantit dhe energjisë elektrike shtoi trysninë e inflacionit. Nisma si adoptimi i *taksës së sheshtë* dhe sistemi i regjistrimit të bizneseve në *one-stop-shop*, ndërthurur me veprimin dinamik për të formalizuar tregun e zi ka sjellë përfitime përmes rritjes së nivelit të mbledhjes së taksave dhe rritjes së investimeve të huaja. Në shtator 2008, raporti i Bankës Botërore e renditi Shqipërinë në vend të dytë mes vendeve që kanë ndërmarrë reforma në vitet

2007-08 për të lehtësuar biznesin, duke parë reforma që kanë thjeshtëzuar dhe zbutur rregullat. Rezultati i saj i përgjithshëm e poziciononte Shqipërinë në pozitë të barabartë me vende të tjera të rajonit të Evropës Juglindore. Megjithëkëtë, shtrirja ekonomike dhe modelet shoqëruese të migrimit vazhdojnë të ndikojnë në ekuilibrin mes rritjes ekonomike dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Potenciali për tregti dhe investim të huaj gjithashtu është ndrydhur nga shqetësimet që rrjedhin nga siguria ligjore dhe fizike e pronës, korrupsioni dhe çmimet e larta të operimit.

Reforma zgjedhore ka shënuar një farë përparimi gjatë vitit të fundit. Megjithëse procesi u zhvillua në mënyrë tejet të zvarritur nga shtatori 2007 deri në prill 2008, Kuvendi më në fund miratoi një sistem të ri zgjedhor. Qershori 2008 pa përrurimin e një Komisioni të Posaçëm të tretë, këtë herë për të hartuar një Kod Zgjedhor të ri. Megjithëse aktorët kyçë kanë shpallur në mënyrë të përsëritur vullnetin e tyre politik për të rënë dakord për një Kod Zgjedhor brenda korrikut 2008, deri më sot procesi ka vazhduar i ngadaltë në pritje të miratimit përfundimtar nga ana e Kuvendit në tetor. Duhet kërkuar konsensusi më i gjerë i mundshëm dhe paketa për të cilën do të bihet përfundimisht dakord duhet të lejojë kohë të mjaftueshme për administrimin e suksesshëm të zgjedhjeve.

Në prill 2008 Kuvendi miratoi ndryshime madhore në Kushtetutë. Amendamentet përfshinin: ndryshime në sistemin zgjedhur, kohëzgjatja e mandatit të Kuvendit, mbledhja e parë e Parlamentit të ri, heqja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nga Kushtetuta, zgjedhja dha mandati i Presidentit, mocionet e besimit për Kryeministrin dhe një mandat kohor për Prokurorin e Përgjithshëm. Megjithëse disa ndryshime shtuan vlerat e megjithëse amendamentet u miratuan në mënyrë legjitime me një shumicë tri të pestat, disa nga ndryshimet shkaktuan shqetësime në lidhje me ndarjen e pushteteve. Miratimi i këtyre ndryshimeve u pasua nga një thirrje për referendum nga disa parti të opozitës dhe figura publike, por që më pas u refuzua nga KQZ-ja me një vendim i cili u ankimua pranë Gjykatës Kushtetuese dhe për të cilin tani pritet një vendim përfundimtar i Gjykatës.

Sa i përket reformës gjyqësore, në shkurt 2008 u miratua një ligj kryesor për pushtetin gjyqësor i cili u pa si një përmirësim i rëndësishëm i procesit ligjor. Në qershor 2008, gjashtë vendet vakante për Gjykatën e Lartë ngjallën debat. U zhvilluan debate të ndezura në lidhje me çështjen nëse Presidenti veproi në mënyrë kushtetuese në procedurat e emërimeve për Gjykatën e Lartë. Qeveria argumentonte se Presidenti paraprakisht duhet të kishte hyrë në diskutime joformale me Kuvendin. Në të vërtetë, shumë vetë e panë votën pasuese kundër kandidaturave të Presidentit nga ana e Kuvendit si një votë politike përkundrejt vendimit të Presidentit për të mos hyrë në konsultime. Çështja u zgjidh vetë pasi Presidenti ngriti një grup ekspertësh për të përcaktuar një paketë kriteresh që duheshin përmbushur nga grupi i kandidatëve të ardhshëm, të cilët më pas u miratuan. Ngritja e grupit të ekspertëve qetësoi situatën dhe për këtë i duhet dhënë meritë e madhe Presidencës që e propozoi këtë ide. Në korrik 2008, Ministria e Drejtësisë përfundoi përgatitjen e projekt-ndryshimeve për ligjin për Prokurorinë dhe në shtator 2008 Kuvendi iu dërgua për shqyrtim një projektligj për administratën gjyqësore. Deri më sot, dy projektligjet, të cilat synojnë të luftojnë korrupsionin brenda gjyqësorit, duket se forcojnë kontrollin e ekzekutivit mbi gjyqësorin, duke ngritur pyetje mbi ndarjen e pushteteve dhe ato nuk u diskutuan si duhet me aktorët kyçë përpara se të paraqiteshin zyrtarisht. Në përgjigje të kritikave nga bashkësia kombëtare, tani po zhvillohen konsultime.

Në tetor 2008, Këshilli i Ministrave miratoi një sërë projektligjesh për Profesionin e Avokatit dhe Noterit, Gjykatat Administrative dhe Shërbimin e Përmbartimit me qëllim, siç pretendohet, që ta përafrojë legjislacionin kombëtar me standardet e BE-së. Megjithëse është ende herët për të komentuar mbi hollësitë e këtyre ligjeve, mund të vërehet se ato u miratuan ose pa iu nënshtruar një procesi të plotë konsultimi publik ose duke shpërfillur komentet e bëra nga bashkësia ndërkombëtare.

Kuvendi vazhdoi të shqyrtonte legjislacionin për ish-bashkëpunëtorët e regjimit komunist duke u përqendruar kryesisht te bashkëpunëtorët e sigurimit të shtetit. Diskutimet nisën në verë dhe vazhdojnë në vjeshtë. Shpresohet që tani do të lejohet koha e mjaftueshme që ligji të shqyrtohet nga Kuvendi dhe e gjithë shoqëria civile, duke mbajtur parasysh ndjeshmërinë e kësaj çështjeje. Gjithsesi, duke qenë se Shqipëria është futur në një vit zgjedhjesh, mbetet për t'u parë nëse do të gjendet një zgjidhje e kënaqshme dhe e qëndrueshme për këtë çështje në të ardhmen e afërt.

Në mars 2008, një sërë shpërthimesh në një depo municionesh ushtarake pranë Tiranës (Gërdec) vranë 26 persona dhe lënduan 300 të tjerë ndërsa u shkatërruan edhe mijëra shtëpi. Prokuroria e Përgjithshme nisi një hetim të plotë, i cili është në vazhdim. Prokuroria e Përgjithshme duhet të vijojë hetimet pa ndërhyrjen e politikës. Në korrik 2008, imuniteti parlamentar i ish-Ministrit të Mbrojtjes u hoq për t'i hapur rrugë hetimeve mbi rolin e tij. Në përpjekjet për rindërtimin e zonës, Qeveria ndërmoi masa madhore duke zhvilluar një strategji koherente pas-rindërtim. Sa i përket sigurisë së zonës, bashkësia ndërkombëtare në mënyrë të përsëritur ka bërë thirrje që perimetri i sigurisë prej 800 metrash përreth zonës së shpërthimit të respektohet si zonë e ndaluar, për aq kohë sa të certifikohet si zonë e sigurt nga ekspertët të huaj të pavarur.

Sa i përket çështjeve të përgjithshme të rendit, përfshirë Policinë e Shtetit, arritja më e madhe e Qeverisë ka qenë miratimi i ligjit të ri për Policinë e Shtetit. Synimi kryesor i ligjit të ri është ndarja e përgjegjësisive politike nga ato operative. Megjithatë, ka pasur shumë raste, sidomos në fushën e emërimeve dhe largimeve, ku vendimet janë marrë nga instanca të larta politike. Në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore, qershori 2008 pa publikimin e një raporti kritik nga Departamenti i Shtetit i SHBA-ve ku thuhej se është shënuar progres i pakët në identifikimin e viktimave të trafikimit dhe se ka pasur mungesë ose rënie të ndjekjes penale të trafikantëve. Në luftën kundër korrupsionit, megjithëse viti i fundit pa një numër zyrtarësh të nivelit të mesëm të cilët u ndoqën penalisht, zyrtarë të lartë publikë dhe grupe kryesore të krimit të organizuar mbeten ende 'në gjendje të lirë'. Megjithëkëtë, në shtator 2008, Treguesi më i fundit i Perceptimeve të Korrupsionit i *Transparency International* shënoi përmirësime të ndjeshme krahasuar me raportin e vitit 2007.

Në administratën publike, viti i fundit pa përsëri një rotacion të konsiderueshëm në organikë, duke vazhduar të mbetet problem niveli i përkatësisë partiake i përdorur në procesin e rekrutimit. Megjithëse një numër i madh i të larguarve janë ankuar me sukses pranë Komisionit të Shërbimit Civil dhe më pas i kanë fituar çështjet e tyre në Gjykatën e Apelit, vetëm një numër i vogël rastesh njihen ku individët janë kthyer në vendet e tyre të mëparshme të punës. Në radhët e policisë, megjithëse shumë prej largimeve mund të kenë qenë të justifikuar, disa nga procedurat e përdorura për largimin e tyre janë parë si jo-transparente. Për më tepër, bashkësia kombëtare ka

vërejtur se si shuma të mëdha të parave të donatorëve janë shpenzuar për të trajnuar shumë zyrtarë të policisë, vetëm për të parë më pas se si këta persona janë larguar dhe janë zëvendësuar nga njerëz të rinj, të cilët më pas duhet të trajnohen nga e para.

Për sa i përket vetë reformës së pronave, çështjet e pazgjidhura të pronës kanë penguar përpjekjet për të zhvilluar një treg trojesh funksional dhe kanë frenuar investitorët e huaj. Boshllëqet në skemën ligjore që rregullon procesin e regjistrimit të parë të pronës kanë penguar një qasje strategjike për të rregulluar statusin e pronave në Kodin Civil në mënyrë që Sistemi i Regjistrimit të Pronave të Paluajtshme (SRPP) të mund të lëshojë tituj pronësie të garantuar. Në lidhje me procesin e kthimit dhe kompensimit, mund të bëhet më shumë për të rritur transparencën dhe për të përsheptuar më tej procesin. Duhet kryer një vlerësim i kërkesave në pritje të paraqitura pranë Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (AKKP) dhe procedurat zbatuese duhen përmirësuar për të rritur efikasitetin. Duhet ndërmarrë edhe një vlerësim mbi aftësinë e Shtetit për të kompensuar ish-pronarët me të holla, pasi si ish-pronarët ashtu edhe Qeveria e kuptojnë se Shteti nuk zotëron fonde të mjaftueshme për të kompensuar 100% të *Vlerës së Drejtë të Tregut* të sotëm si kompensim për shpronësimet.

Në lidhje me reformën në sektorin e mediave, në korrik 2008 Kuvendi inicioi një projektligj për transmetimet radio-televizive i cili synon të unifikojë ligjet ekzistuese, atë për Radion dhe Televizionin Publik dhe Privat dhe ligjin për Transmetimet Numerike. Gjithsesi, garancitë që projektligji ofron për pavarësinë e Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT) dhe të Radio-Televizionit Shqiptar (RTSh) duken të pamjaftueshme dhe ka ende një mungesë përparimi në hartimin e një strategjie dixhitale të konsultuar gjerë. Kjo situatë bie në kundërshti me Planin e Veprimit të adoptuar në vitin 2007 me Komisionin Evropian dhe Këshillin e Evropës (KE) i cili parashikon miratimin e një ligji të ri për transmetimet përmes një procesi transparent. KKRT-ja vazhdon të kritikohet për vendimet e saj të dukshme jo-transparente të licencimit dhe për mungesën e perceptuar të pavarësisë së saj nga Qeveria – një kritikë e cila i drejtohet edhe RTSh-së. Më 1 tetor 2008, Përfaqësuesi i Lirisë së Mediave u shprehu aktorëve të Kuvendit shqetësim në lidhje me këto zhvillime.

Në lidhje me reformën për barazinë gjinore, nëse shihen raportet dhe treguesit ndërkombëtarë, është e drejtë të thuhet se mbetet ende shumë punë për të bërë. Vetëm 7% e Parlamentit është e përbërë nga gratë dhe vetëm 2% e kryebashkiakëve janë gra. Edhe pse një kuotë është prezantuar për përfaqësimin e grave në disa struktura të partive politike, një kuotë e tillë nuk ekziston ende për përfaqësimin e grave të zgjedhura. Megjithëkëtë, duket se ka një farë optimizmi se Kodi Zgjedhor do të promovojë një përfaqësim më të barabartë (Në projekt-propozimet më të fundit është propozuar një kuotë gjinore prej 30%. Mbetet për t'u parë nëse ky propozim, në formën e tij aktuale, do të konvertohet konkretisht në më shumë mandate parlamentare për gratë). Pritet gjithashtu që ligji i miratuar së fundmi për Barazinë Gjinore (korrik 2008) të zbatohet plotësisht, me Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe kundër Dhunës në Familje duke vepruar si një vegël e fuqishme në këtë drejtim.

3. VEPRIMTARITË E PREZENCËS

Prezenca ka vijuar të ndihmojë autoritetet shqiptare dhe shoqërinë civile për të promovuar demokratizimin, shtetin e të drejtës, të drejtat e njeriut dhe për të konsoliduar institucionet demokratike në përputhje me parimet, angazhimet dhe mandatin e OSBE-së. Prezenca ka thjeshtëzuar më tej strukturën e saj për donacionet dhe bashkërendimin e projekteve dhe ka vënë më tepër theksin në planifikimin strategjik të veprimtarive të saj. Zyrat e Projekteve kanë vazhduar të ofrojnë mbështetje për të gjitha veprimtaritë që janë në përputhje me mandatin e Prezencës, duke vendosur kontakte me aktorët vendorë, rajonalë dhe qeveritarë, duke u ofruar atyre këshillim dhe kontakte të mëtejshme dhe duke zbatuar elementët vendorë të projekteve më të gjera.

3.1. KRYETARI I PREZENCËS

Prezenca ka vazhduar të mbajë kontakte të rregullta me aktorët politikë dhe përfaqësuesit ndërkombëtarë për të përmirësuar cilësinë e punës së Prezencës dhe për t'u përshtatur kur është e nevojshme. Një pjesë e madhe e punës është përqendruar në çështjet e bashkërendimit të donatorëve ku Prezenca ka vazhduar të luajë një rol aktiv në strukturat e Sekretariatit Teknik të Donatorëve (STD) së bashku me Delegacionin e Komisionit Evropian në Tiranë, Bankën Botërore dhe përfaqësitë e Kombeve të Bashkuara – ku përfshihet edhe një periudhë gjashtëmujore si kryetare e këtij sekretariati. Në maj të vitit 2008, si pjesë e strukturave të STD-së, qeveria e mbështetur nga Prezenca mbajti një takim të nivelit të lartë mbi strategjinë 'pas-Gërdecit', në të cilin qeveria informoi donatorët mbi procesin e rindërtimit. Prezenca gjithashtu ka financuar botimin e buletinit të përmuajshëm për bashkërendimin e donatorëve i cili përmbante informacion për të gjithë donatorët mbi veprimtaritë në vazhdim me qëllim shmangien e dublimeve.

3.2. BASHKËPUNIMI NË ÇËSHTJET E SIGURISË

Prezenca ka vijuar me ndihmën e saj për Policinë e Shtetit (PSh) dhe Policinë e Kufirit dhe Migracionit si (PKM) dhe për Ministrinë e Mbrojtjes (MM).

3.2.1. Policia e Shtetit – Gjatë vitit të fundit janë organizuar trajnime mbi teknikat e intervistimit dhe hetimit për hetuesit e policisë të nivelit të mesëm. Në korrik të vitit 2008, Policisë së Shtetit iu dha mbështetje në organizimin e një konference ndërkombëtare me pjesëmarrës nga Mali i Zi, Kosova/UNMIK dhe ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë për të diskutuar mbi metodologjitë e trajnimit të policisë dhe për të evidentuar burimet trajnuese në mënyrë që të krijohet një rrjet trajnuesish. Mbështetje është siguruar gjithashtu edhe për kryerjen e provimit të hyrjes në Policinë e Shtetit.

3.2.2. Policia e Kufirit dhe Migracionit (PKM) – Janë bërë trajnime për përdorimin e pajisjeve bashkëkohore për kontrollin e kufirit ku rrjedhimisht këto pajisje i janë dhuruar PKM-së. Ndër pajisjet e dhuruara deri më sot përfshihen pajisje me rreze infra të kuqe për të parë natën, pajisje pamore termale, një numër i madh dylbish, sisteme të pozicionimit global (GPS), video kamera dhe komplete radios. Në qershor të vitit 2008 nisi trajnimi për gjuhën e huaj për oficerët e PKM-së në pikat e kalimit kufitar i cili do të përfundojë në mars të vitit 2009. Në vitin 2008 u kryen

trajnime për kontrollin e automjeteve dhe teknikat e luftës kundër trafikimit dhe kontrabandës në këto pika kufitare. Janë mundësuar takime të përbashkëta në pikëkalimet kufitare ndërmjet policisë kufitare të Shqipërisë dhe të Malit të Zi dhe ndërmjet PKM-së dhe shërbimit policor kufitar të Kosovës/UNMIK. Prezenca, Misioni Monitorues i OSBE-së në Shkup dhe shërbimet policore të dy vendeve u takuan për të përmirësuar bashkëpunimin ndërkufitar. Janë mundësuar takime edhe ndërmjet PKM-së dhe *Guardia di Finanza* të Italisë, policisë kufitare të Greqisë dhe autoriteteve të UNMIK-ut për bashkërendimin e çështjeve kufitare. Mbështetje i është dhënë gjithashtu Njësisë së Çështjeve Strategjike Policore përmes një projekti për rritjen e bashkëpunimit ndërmjet policisë, prokurorëve dhe gjyqtarëve në luftën kundër krimit të organizuar.

3.2.3. Asgjësimi i melanzhit – Pas kërkesës për mbështetje të Qeverisë Shqiptare drejtuar Forumit për Bashkëpunim në Çështjet e Sigurisë, më 25 korrik 2008, Ministri shqiptar i Mbrojtjes dhe Kryetari i Prezencës nënshkruan një marrëveshje për asgjësimin e një komponenti toksik të karburantit të raketave të njohur si *melanzh* (një kombinim i dy substancave toksike: oksidues dhe samin). Së shpejti, një kompani suedeze do të zbatojë një projekt sipas të cilit do të eksportohen në Suedi rreth 30000 litra karburant toksik stok për t'u asgjësuar.

3.3. QEVERISJA NË ÇËSHTJE TË EKONOMISË DHE MJEDISIT

Ky program përqendrohet në qeverisjen e çështjeve të ekonomisë dhe mjedisit, ku përfshihen qeverisja vendore dhe reforma rajonale, reforma e pronës dhe aspektet jopolicore të anti-trafikimit.

3.3.1. Reforma rajonale – Në kuadër të promovimit të udhëheqjes në qeverisjen vendore, në pesë bashki u zbatua programi i udhëheqjes së bashku me Këshillin e Evropës dhe Shoqatën e Bashkive të Shqipërisë. Në këtë program u mbështetën pesë njësitë e pushtetit vendor për të përmirësuar shërbimet e ofruara dhe aftësitë për të mbrojtur interesat e tyre. Në kuadër të mbështetjes së grave të zgjedhura si kryetare të njësisve vendore, janë organizuar forume për gratë udhëheqëse dhe është siguruar mbështetje teknike për të rritur kapacitetet e tyre. Gjithashtu i është ofruar ndihmë qeverisë në hartimin e strategjisë së zhvillimit rajonal përmes mbështetjes me diskutime këshillimore dhe një vizitë studimore në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë.

3.3.2. Qeverisja e mirë – Në kuadër të luftës kundër korrupsionit, në tetor 2007, Prezenca ka mbështetur Qeverinë në hartimin e *Strategjisë Kombëtare kundër Korrupsionit* me anë të organizmit të një tryeze të rumbullakët me donatorët. Në shkurt 2008, po në mbështetje të Qeverisë, u organizua konferenca mbi përpjekjet e pushtetit vendor në luftën kundër korrupsionit. Në maj 2008 Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive u asistua për trajnimin e punonjësve të zyrës së taksave dhe doganës mbi kuadrin ligjor për konfliktin e interesave dhe deklarimin e pasurive. Në nëntor 2007, Komisioni Parlamentar për Sigurinë Kombëtare u asistua në organizimin e një konference për anti-korrupsionin me parlamentarë nga rajoni. Në tetor 2007, së bashku me Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe një OJF vendase partnere, u botua një manual i OCEEA-s (Zyra e Koordinatorit të OSBE-së për Veprimtaritë Ekonomike dhe Mjedisore) dhe u mbajtën seminare mbi praktikën më të mira të investimeve. Deri në nëntor 2007 u siguroi mbështetje

publike nga 21 operatorë turistikë për Kodin e Sjelljes të Organizatës Botërore të Turizmit për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual në Turizëm. Për operatorët pjesëmarrës u organizuan trajnime për zbatimin e kodit si dhe u krye një vizitë studimore në Malin e Zi. Gjithashtu, Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Brendshme prodhuan reklama televizive për sensibilizimin e publikut mbi rrezikun e shfrytëzimit të fëmijëve në industrinë e turizmit. Një përparim i dukshëm është vërejtur në zbatimin e Konventës së Aarhusit me Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Menaxhimit të Ujërave, pjesë e të cilit ka qenë edhe hapja e dy Qendrave Aarhus të Informimit. Këto ambiente së bashku me krijimin e një faqeje interneti kombëtare për Aarhusin dhe mbledhjeve të rregullta të Bordit Këshillimor për Aarhusin, kanë bërë të mundur adresimin e një sërë çështjesh në Qeveri. Në maj 2008 u nënshkrua një Memorandum Mirëkuptimi me Ministrinë për të forcuar pjesëmarrjen e publikut në vlerësimet e ndikimeve në mjedis. Në prill 2008, me mbështetjen e OCEEA-s, u krye një vizitë studimore në Austri me zyrtarë të Ministrisë në mënyrë që ata të shihnin funksionimin e sistemeve të integruara të menaxhimit të mbetjeve. Në shtator 2008 u krye gjithashtu një vizitë studimore për mekanizmat e miratuar të pjesëmarrjes së publikut në Vlerësimin e Ndikimeve në Mjedis sipas Konventës së Espoos.

3.3.3. Reforma e pronës – Në vitin 2007 përfundoi faza e dytë e një projekti me Sistemin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për regjistrimin e parë. Gjatë kësaj faze u regjistruan dy zonat më të mëdha informale si dhe 34000 prona. Faza e dytë e projektit filloi me Agjencinë për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave. Gjatë fazës së parë u dixhitalizuan 350 000 dokumente dhe të dhënat që përmbanin u hodhën në një bazë të dhënash. Në fazën e dytë, bazës së të dhënave iu shtua teknologjia GIS (Sistemi Gjeografik i Informacionit) në mënyrë që AKKP-ja të ishte në gjendje të përcaktonte vendndodhjen e pronave të pretenduara në një hartë mbështetëse bazë. U dërguan rreth 1900 harta nga forcat e armatosura, agjencia shtetërore e gjeodezisë dhe nga ZRPP të cilat më pas u përqasën gjeografikisht për të krijuar një hartë mbështetëse bazë të koordinuar. Në shtator 2008, Prezenca nënshkroi një marrëveshje me Delegacionin e Komisionit Evropian për zbatimin e një projekti për regjistrimin e pasurive në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë ku do të marrin pjesë më shumë donatorë.

3.3.4. Anti-trafikimi – Në këtë drejtim është dhënë asistencë teknike në hartimin e manualeve për institucionet e zbatimit të ligjit dhe agjencitë që ofrojnë shërbime sociale për viktimat e trafikimit. Efektivat policorë të anti-trafikimit, policisë kufitare dhe policisë së shtetit janë trajnuar për Mekanizmin Kombëtar të Referimit, teknikat e intervistimit, si dhe për identifikimin, referimin dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit. Këto viktimat janë trajnuar për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro dhe katër personave u janë dhënë mikro-kredi. Është nënshkruar një marrëveshje me një partner lokal mikro-financues për zbatimin e projektit të OCEEA-s për nxitjen e fuqizimit ekonomik të grave. Në mënyrë që të përmirësohej analizimi i të dhënave, është dhënë ndihmesë në krijimin e një baze të dhënash me rastet e trafikimit e cila do të sigurojë të dhëna të besueshme mbi masat e marra në procesin e mbrojtjes dhe mbështetjes së viktimave të trafikimit. Mbështetje i është dhënë edhe Koordinatorit Kombëtar të Anti-trafikimit për organizimin e takimeve ndërkufitare ndërmjet ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Kosovës/UNMIK dhe Shqipërisë. Zyra e Koordinatorit Kombëtar të Anti-trafikimit është asistuar gjithashtu në hartimin e strategjisë së re për anti-trafikimin, e cila u prezantua gjatë një Konference Kombëtare në maj 2008. Në

nëntor 2008, Ministrisë së Brendshme iu dërguan komente me shkrim për zbatimin e strategjisë.

3.4. DEMOKRATIZIMI

Prezenca është përqendruar në reformën zgjedhore, reformën e gjendjes civile, ndërtimin e kapaciteteve të Kuvendit, barazinë gjinore, shoqërinë civile dhe mediat.

3.4.1. Reforma zgjedhore – Në shtator 2007 u mbështet organizimi i një seminari të përqendruar në modelet për sistemin e ardhshëm zgjedhor i cili u pasua nga një veprimtari tjetër në dhjetor 2007 ku u dhanë rekomandime për Kuvendin. Në shkurt 2008, së bashku me Këshillin e Evropës, UNIFEM dhe dy OJF vendase, u mbajt një seminar për nxitjen e përfaqësimit të grave, rezultatet e të cilit iu dërguan Kuvendit. Në korrik u mbajt një seminar për zgjedhësit me aftësi të kufizuara ku dy OJF-të kryesore në këtë fushë diskutuan propozimet e tyre. Dokumenti përfundimtar, i cili pasqyron pikëpamjet e dy OJF-ve, iu dërgua Kuvendit. Në gusht, me kërkesë të Komisionit të Posaçëm, Prezenca e OSBE-së mbështeti punën e këtij komisioni duke pajtuar ekspertizë ligjore vendase.

3.4.2. Gjendja civile - Me një fond të konsiderueshëm nga KE-ja, u kompjuterizuan të dhënat e 4.2 milionë shtetasve me anë të procesit të hedhjes së të dhënave, proces i cili përfundoi në korrik 2008. Prezenca tani po përqendrohet në sigurimin e një metodologjie të njëtrajtshme për krijimin dhe administrimin e adresave, gjë e cila po bëhet nën kujdesin e Projektit të Bankës Botërore për Menaxhimin e Tokës. Në bashkëpunim me KE-në, iu dha ndihmesë Ministrisë së Drejtësisë në hartimin e një ligji të ri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale i cili u miratua në mars 2008. Në gusht 2008, Ministria e Brendshme filloi lëshimin e certifikatave të printuara në zyrat e gjendjes civile në Tiranë dhe në dy njësi të tjera vendore. Certifikatat u gjeneruan nga baza e të dhënave që përmendëm më sipër e cila u krijua nga kompjuterizimi i të dhënave të gjendjes civile që gjendeshin në regjistrat themeltarë. Pritet që deri në tetor 2008, të 320 zyrat e gjendjes civile të jenë në gjendje të lëshojnë certifikata lindjeje të printuara dhe të ruajnë cilësinë e të dhënave.

3.4.3. Mbështetja për Kuvendin – Gjatë vitit të fundit, Komisioni Parlamentar për Integrimin Evropian është asistuar për organizimin e disa forumeve politikash në vend, ku shoqëria civile dhe zyrtarët vendas kanë diskutuar çështje që lidhen me integrimin në BE. Në korrik 2008, studentja e parë e sponsorizuar përfundoi studimet në Kolegjin e Evropës (Bryzh) dhe u punësua më vonë nga Kuvendi për të asistuar këtë Komision Parlamentar. Të njëjtin kurs në Kolegjin e Evropës po e ndjekin tani edhe dy studentë të tjerë. Kapacitetet e personelit të Kuvendit janë rritur si rezultat i një programi rajonal trajnimi të BE-së dhe një vizite studimore në Bruksel. Seminare për personelin e Kuvendit në lidhje me integrimin evropian janë mbajtur në Shqipëri, Malin e Zi, ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Bosnjë-Hercegovinë, në bashkëpunim me projektet e tyre përkatëse parlamentare. Në janar 2008, u organizua një vizitë studimore për deputetët në Parlamentin e Portugalisë për të mësuar rreth rolit të Parlamentit në procesin e reformave. Filloi bashkëpunimi me Parlamentin e Holandës me qëllim transferimin e ekspertizës të Biblioteka dhe Shërbimi Kërkimor i Kuvendit dhe Arkiva. Në prill 2008, u krijua një grup i grave parlamentare për të rritur pjesëmarrjen e grave në Kuvend. Në korrik 2008, u mbajtën disa seminare mbi

strategjitë e trajnimit për personelin e Kuvendit. Në shtator 2008, Kuvendi u asistua për finalizimin e broshurave promovuese mbi punën e Kuvendit.

3.4.4. Çështjet Gjinore – Gjatë hartimit të ligjit për barazinë gjinore, Prezenca punoi ngushtë me Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Mundësive të Barabarta në mbështetje të diskutimeve në Kuvend. Pas miratimit të ligjit, Prezenca filloi të punojë me Ministrinë për hartimin e akteve nënligjore në bashkëpunim me UNIFEM. Prezenca bashkë-kryeson koordinimin e mbështetjes së donatorëve për barazinë gjinore dhe në janar 2008 u mbajt një takim bashkërendues i donatorëve për Projekt Strategjinë për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje, financuar me mbështetjen e Prezencës. Ministrisë iu siguruan komente me shkrim mbi projekt strategjinë sektoriale dhe mbështetje për publikimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit.

3.4.5. Shoqëria civile – Në korrik 2008, Rrjeti Kombëtar i Qendrave të Zhvillimit të Shoqërisë Civile u mblodh për të diskutuar një projektligj për menaxhimin e fondeve shtetërore për shoqërinë civile. Megjithatë, gjatë vitit të fundit, disa nga këto qendra nuk kanë arritur të tërheqin fonde të mjaftueshme jashtë Prezencës që të vazhdonin të ekzistonin: qendrat në Elbasan dhe Shkodër u mbyllën përkatësisht në korrik dhe shtator 2008, qendra e Kukësit u shkri me Qendrën e Këshillimit të Grave në Kukës, ndërsa qendrat e Vlorës dhe Durrësit do të vazhdojnë të përdorin fondet e mbledhura brenda komunitetit vendas. Qendra e Korçës do të mbetet e hapur bazuar në një format të ri në bashkëpunim me Bashkinë e Korçës. Financime donatorësh u kanalizuan edhe për Qendrën e Këshillimit të Grave dhe Shërbimeve Sociale të Kukësit.

3.4.6. Media – Në tetor 2007, Prezenca nënshkroi një Memorandum Mirëkuptimi me Këshillin Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT), nëpërmjet të cilit Prezenca do t'i siguronte një ekspert të huaj për të asistuar në hartimin e një strategjie në lidhje me kalimin nga transmetimet analoge në ato numerike, asistencë që u dha nga një ekspert francez gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit. Më pas, KKRT-ja organizoi disa konferenca në nivel qarku me këtë temë, me mbështetjen dhe pjesëmarrjen e Prezencës. Prezenca lehtësoi pjesëmarrjen e Radio Televizionit Shqiptar (RTSh) në një nismë të përbashkët për mbledhje fondesh të transmetuesve publikë në Shkup. Megjithatë, në shtator 2008 nuk është ende e qartë nëse KKRT-ja dëshiron ta vazhdojë këtë bashkëpunim. Në shtator 2008, u nënshkrua një projekt për forcimin e kapaciteteve të mediave me Delegacionin e Komisionit Evropian dhe ai do të zbatohet nga Prezenca dhe Fondacioni Friedrich Ebert. Qëllimi është mbështetja për pavarësinë e mediave përmes nxitjes së debatit publik mbi politikën e mediave përmes krijimit të një organi vetërregullues.

3.5. SHTETI I SË DREJTËS DHE TË DREJTAT E NJERIUT

Prezenca asistoi reformën legjislative dhe gjyqësore, duke mbështetur zhvillimin e një sistemi ligjor efektiv dhe transparent me qëllim që qytetarët të kërkojnë dhe të marrin zgjidhje efektive.

3.5.1. Reforma gjyqësore – Në dhjetor 2007, u publikua një analizë e procedimeve të çështjeve penale në apel, e cila jepte rekomandime për rritjen e paanësisë dhe efikasitetit. Për të rritur profesionalizmin gjyqësor, është ofruar trajnim mbi etikën gjyqësore, ku përfshihej edhe një vizitë studimore e Komisionit të Etikës së

Konferencës Kombëtare Gjyqësore dhe një zyrtari të Këshillit të Lartë të Drejtësisë në Barcelonë. Mbështetja për Komisionin e Etikës vazhdoi me marrjen e nismës së hartimit të një komentari mbi Kodin e Etikës Gjyqësore. Për të ndihmuar në rritjen e aksesit në drejtësi të grave viktime të dhunës në familje, si dhe për të rritur ndërgjegjësimin rreth ligjit të ri për dhunën në familje, janë zhvilluar trajnime për profesionistë në fushën e ligjit dhe shoqërinë civile me mbështetjen e Këshillit të Evropës, Shkollës Shqiptare të Magjistraturës dhe Ministrisë së Drejtësisë. Është botuar një udhërrëfyes për rritjen e ndërgjegjësimit për dhunën në familje, i cili iu shpërnda profesionistëve të fushës së ligjit, policisë dhe shoqërisë civile. Në korrik 2008, nga Prezenca dhe USAID u publikua Manuali i Gjyqtarit për Lëshimin e Urdhrave të Mbrojtjes për t'u dhënë gjyqtarëve orientim për interpretimin dhe zbatimin e ligjit të ri për dhunën në familje.

3.5.2. Reforma në drejtësi – Për të promovuar dënimet alternative ndaj burgimit, Ministria e Drejtësisë u asistua për krijimin e Shërbimit Kombëtar të Provës dhe në tetor 2007, Ministrisë së Drejtësisë iu dërgua një projektstrategji për zhvillimin e një sistemi prove, me komente me shkrim mbi projekt kuadrin ligjor fillestar dërguar në nëntor 2007. Nga shkurti 2008, Prezenca filloi të kryesoje Grupin Këshillimor të Provës për të asistuar Ministrinë e Drejtësisë në zhvillimin e shërbimit të provës. Në dhjetor 2007, për të rritur transparencën në procesin e hartimit të ligjeve, janë mbajtur disa seminare mbi teknikat e komentimit të projektligjeve. Në janar 2008, i është dhënë mbështetje Ministrisë së Drejtësisë për organizimin e një tryeze të rrumbullakët për të diskutuar projekt-ndryshimet e Kodit Penal dhe ligjit për Ekzekutimin e Vendimeve Penale. Prilli 2008 pa pjesëmarrjen në një grup pune të kryesuar nga Ministria e Drejtësisë për projekt-ndryshimet në ligjin për noterët, ku më pas komentet me shkrim iu dërguan Ministrisë së Drejtësisë. Janë mbështetur edhe grupet e punës mbi legjisacionin në lidhje me policinë në hartimin e rregullave të reja disiplinore dhe rregullave të reja të personelit në zbatim të Ligjit për Policinë e Shtetit; si dhe në hartimin e një ligji të ri për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm për policinë dhe për Ministrinë e Brendshme. Vitin e kaluar Prezenca i siguroi asistencë edhe Drejtorisë së Ministrisë së Brendshme për Mbrojtjen e Dëshmitarëve përmes hartimit të ligjit të ri për mbrojtjen e dëshmitarëve. Në korrik 2008, sipas një kërkesë, Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit iu dërguan komente me shkrim mbi projektligjin për planifikimin territorial. Në gusht 2008, iu dërguan komente me shkrim Ministrisë së Drejtësisë mbi ndryshimet më të fundit në ligjin për ekzekutimin e vendimeve penale dhe mbi Ligjin për Kodin Penal, si dhe Ministrisë së Brendshme mbi Strategjinë për Administratën Publike.

3.5.3. Të drejtat e njeriut – Vitin e fundit u pa një bashkërendim i punës së komunitetit ndërkombëtar mbi reformën e burgjeve dhe të drejtat e romëve. Bashkë me Zyrën e Avokatit të Popullit, brenda qendrave të paraburgimit u vendosën disa kuti postare ku Avokati i Popullit do të ketë të drejtë hyrjeje për të siguruar korrespondencë të lirë. Në tetor 2007, ekspertëve gjyqësorë iu ofruan trajnim mbi të drejtën ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijëve në raste familjare. Një pjesëmarrje e vazhduar u pa në Konsorciumin Ndërkombëtar (me ICITAP-in, Delegacionin e KE-së, *Interforza*-n dhe Policinë e Shtetit). Mbështetje teknike iu siguroa Drejtorisë së Mbrojtjes së Dëshmitarëve në hartimin e një ligji të ri për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe Prezenca ndihmoi në bashkërendimin e veprimtarive për të forcuar kapacitetet e Zyrës së Mbrojtjes së Dëshmitarëve. Prezenca ka kryesuar Nën-grupin e Reformës së

Burgjeve dhe ka marrë pjesë në Nën-grupin e Drejtësisë për të Miturit, i cili ka asistuar qeverinë në planet e saj për ambiente të paraburgimi për të mitur

4. PUNA NË TË ARDHMEN

Viti 2009 do të jetë një vit i rëndësishëm në dritën e aspiratave të Shqipërisë për integrimin Euro-Atlantik. Zgjedhjet parlamentare do të mbahen sipas një sistemi të ri zgjedhor, i cili duhet të rezultojë në mbajtjen e zgjedhjeve demokratike. Prezenca do ta asistojë Shqipërinë në përpjekjet e saj integruese në fushat e përcaktuara në mandat, do të asistojë në hartimin e ligjeve përkatëse dhe nxitjen e një procesi konsultimi gjithëpërfshirës në të gjitha nivelet e ciklit legjislativ. Një parakusht për arritjen e suksesit përfundimtar do të jetë vazhdimi i konsensusit politik mbizotërues mes aktorëve vendas.

Prezenca do të thjeshtëzojë më tej strukturën e saj të bashkërendimit të donatorëve dhe projekteve, si dhe do t'i mëshojë më shumë planifikimit strategjik dhe menaxhimit të veprimtarive të saj. Departamenti i Bashkëpunimit në Çështjet e Sigurisë do të ofrojë mbështetje për të forcuar më tej kapacitetet e Policisë së Shtetit dhe Policisë së Kufirit dhe Migracionit në arritjen e strategjisë së saj të menaxhimit të integruar të kufijve, si dhe për të realizuar objektivat e saj në luftën kundër krimit. Departamenti i Mirëqeverisjes në Çështjet Ekonomike dhe Mjedisore do të ofrojë asistencë me qëllim forcimin e llogaridhënies në pushtetin vendor; për të mbështetur strategjitë e decentralizimit dhe për të siguruar mbështetje për forcimin e kapaciteteve të pushtetit vendor për dhënien e shërbimeve publike; për të asistuar në proceset e reformës së pronave dhe për të mbështetur përpjekjet në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Brenda Departamentit të Demokratizimit, progresi do të shihet edhe në përfundimin e projektit të Prezencës për modernizimin e sistemit të gjendjes civile dhe punës së vazhdueshme për sistemin e adresave. Gjithashtu, Prezenca do të mbështesë reformën zgjedhore; do të asistojë Kuvendin në ushtrimin e rolit të tij mbikëqyrës mbi ekzekutivin dhe institucionet e tjera të pavarura; do të forcojë përfshirjen e shoqërisë civile, ku të kërkohet barazia gjinore në politikat e Qeverisë; do të asistojë në kuadrin legjislativ për mediat, do të ndihmojë për rritjen e pavarësisë së mediave, si dhe për zhvillimin e kapaciteteve institucionale të transmetuesit publik. Departamenti i Shtetit të së Drejtës dhe të Drejtave të Njeriut do të ofrojë mbështetje për sistemin gjyqësor me qëllim që standardet e gjyqimit të drejtë të arrijnë standardet e Bashkimit Evropian, që ligjet të hartohen në interes të së mirës së përbashkët dhe që reforma në administratën publike të bëhet e bazuar mbi parimet e meritës, si dhe për rritjen e respektit për të drejtat e njeriut të qytetarëve të tij.

Fundi i tekstit